



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
Prishtinë - Prishtina

KOLEGJI "PJETËR BUDI" - PRISHTINË

PROGRAMI: DOGANË DHE SHPEDICION

TEMA BAÇELOR

**Përshtatja e markës kosovare për tregjet
ndërkombëtare: Analiza e strategjive të marketingut**

Mentori:

Dr.Sc. Haqif Arifi

Studenti:

Erion Kuka

Prishtinë, 2025

ABSTRAKT

Hyrje: Ky studim trajton mënyrën se si markat kosovare po përshtaten për të depërtuar në tregjet ndërkombëtare. Në një ekonomi globale gjithnjë e më konkurruese aftësia për të përshtatur identitetin e markës ndaj kulturave dhe pritshmërive të konsumatorëve ndërkombëtarë është bërë një faktor vendimtar për suksesin afarist.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të trajtojë strategjitë që markat kosovare përdorin për t'u përshtatur në tregjet ndërkombëtare dhe për të identifikuar sfidat dhe mundësitë që hasin gjatë këtij procesi.

Metodologjia: Studimi përdor metodën e shqyrtimit të literaturës dhe analizës krahasuese duke analizuar dy raste konkrete Dovolli Grup dhe Jaffa Champion. Këto raste u përzgjedhën për shkak të përvojës së tyre të suksesshme në Kosovë dhe përdorimin e strategjive të përshtatura marketing.

Rezultatet: Analiza tregoi se markat kosovare që investojnë në kërkime të tregut përshtatje kulturore dhe komunikim digjital kanë më shumë gjasa të krijojnë imazh pozitiv dhe besueshmëri në tregjet ndërkombëtare.

Konkluzioni: Suksesi i markave kosovare në tregjet globale varet nga aftësia e tyre për të ruajtur identitetin kombëtar duke e kombinuar me fleksibilitetin kulturor dhe inovacionin strategjik.

Fjalë kyçe: Markë kosovare, tregje ndërkombëtare, strategji marketingu, përshtatje kulturore, ndërkombëtarizim.

Përmbajtje

1. Hyrje	4
2. Deklarimi i problemit.....	6
2.1 Qëllimi i studimit	6
2.2 Objektivat e studimit.....	6
2.3 Pyetjet hulumtuese	7
3. METODOLOGJIA	7
3.1 Dizajni i studimit.....	7
4. Shqyrtimi i literatures	8
4.1 Konceptet dhe definicionet e markës në kontekstin ndërkombëtar	8
4.2 Teoritë dhe modelet e ndërkombëtarizimit të markave	9
4.3 Rëndësia e përshtatjes së markës për tregjet ndërkombëtare.....	12
4.4 Strategjitë e pozicionimit të markës në tregjet ndërkombëtare.....	13
4.5 Strategjitë e komunikimit ndërkulturor në marketingun ndërkombëtar	15
4.6 Ndikimi i kulturës në perceptimin dhe pozicionimin e markës në tregjet ndërkombëtare.....	17
4.7 Sfidat dhe mundësitë e markave kosovare në tregjet ndërkombëtare	19
4.8 Ndikimi i kulturës dhe identitetit kombëtar në ndërtimin e markës ndërkombëtare .	21
4.9 Roli i inovacionit dhe teknologjisë në ndërkombëtarizimin e markave kosovare	23
4. Rezultatet	26
Rasti 1: Devolli Group, udhëtimi i një marke kosovare drejt tregjeve ndërkombëtare	26
Rasti 2: Marka “Jafa Champion”, strategjia e ndërkombëtarizimit të një marke tekstili kosovare	29
5. KONKLUSIONE DHE PERFUNDIME	32
6. REKOMANDIME	35
REFERENCA	36

1. Hyrje

Konkurrenca ndërmjet markave nuk kufizohet më vetëm brenda kufijve kombëtarë por shtrihet në një treg botëror gjithnjë e më të hapur e të ndërlidhur. Kjo ka bërë që kompanitë pavarësisht madhësisë së tyre të përballen me sfidën e përshtatjes me kërkesat, normat dhe pritshmëritë e konsumatorëve ndërkombëtarë.

Një markë nuk përfaqëson vetëm një produkt apo shërbim ajo është një simbol identiteti, kulture dhe perceptimi publik që ndërtohet përmes strategjive të kujdesshme të marketingut dhe komunikimit (Keller, 2013). Për vende të vogla si Kosova roli i markave bëhet edhe më i rëndësishëm pasi ato janë ambasadore të imazhit ekonomik dhe kulturor të vendit në arenën ndërkombëtare (Kotler & Keller, 2016).

Që nga shpallja e pavarësisë më 2008, Kosova ka bërë përpjekje të dukshme për të zhvilluar sektorin privat dhe për të rritur eksportet por ndërkombëtarizimi i markave të saj mbetet një proces i vështirë. Sfida kryesore qëndron në faktin se shumë kompani kosovare nuk kanë përvojë të mjaftueshme në analizën e tregjeve të huaja në përshtatjen e produktit me kulturën e konsumatorëve apo në krijimin e një narrative unike që të rezonojë globalisht (Rexhepi & Mustafa, 2020). Kërkimi i mënyrave se si markat kosovare mund të ndërtojnë strategji efektive të marketingut ndërkombëtar është bërë një domosdoshmëri për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Ky studim fokusohet në analizimin e mënyrës se si markat kosovare përshtaten për tregjet ndërkombëtare duke marrë si raste studimore Devolli Group dhe Jafa Champion. Zgjedhja e këtyre dy kompanive bazohet në faktin se përfaqësojnë dy modele të ndryshme zhvillimi. Devolli Group si një kompani tradicionale e konsoliduar dhe me prani në tregjet rajonale e evropiane ndërsa Jafa Champion si një markë moderne e orientuar drejt inovacionit, marketingut digjital dhe konsumatorëve të rinj globalë. Analiza e tyre synon të nxjerrë në pah se cilat janë strategjitë më efektive që një markë kosovare mund të ndjekë për t'u bërë konkurrese në tregjet ndërkombëtare (Gashi, 2023).

Përveç aspektit ekonomik studimi ka rëndësi edhe në dimensionin kulturor dhe imazherik të Kosovës. Një markë e suksesshme jashtë vendit nuk është vetëm një tregues i performancës së biznesit por edhe një kontribut i drejtpërdrejtë në ndërtimin e reputacionit

të shtetit në nivel global. Produktet e markave kosovare që eksportohen në Bashkimin Evropian apo në tregjet e diasporës shpesh perceptohen si përfaqësuese të cilësisë dhe qëndrueshmërisë së ekonomisë vendore (Beqiri, 2022). Kjo tregon se marketingu ndërkombëtar nuk është vetëm një çështje tregtare por edhe një proces strategjik i ndërtimit të identitetit kombëtar përmes ekonomisë.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë procesin e përshtatjes së markave kosovare në tregjet ndërkombëtare përmes strategjive të marketingut të identifikojë pengesat strukturore dhe organizative që i kufizojnë dhe të propozojë mënyra të reja të qasjes që mund të përmirësojnë imazhin dhe konkurrueshmërinë e tyre.

Përmes një analize krahasuese të dy rasteve të përzgjedhura, hulumtimi synon të japë një pasqyrë të thelluar mbi mënyrën se si markat kosovare mund të ndërtojnë qëndrueshmëri dhe vlerë në tregjet ndërkombëtare (Hoxha, 2021).

2. Deklarimi i problemit

Markat e vendeve të vogla përballen me sfida të mëdha për të hyrë dhe për t'u pozicionuar me sukses në tregjet ndërkombëtare. Për Kosovën e cila ende është në proces zhvillimi ekonomik e institucional kjo sfidë bëhet edhe më e ndërlikuar. Pavarësisht rritjes së ndjeshme të prodhimit vendor dhe ambicies për eksport shumë kompani kosovare hasin vështirësi në përshtatjen e strategjive të marketingut me kërkesat dhe preferencat e konsumatorëve ndërkombëtarë.

Problemi kryesor që trajton ky studim është mungesa e strategjive të qarta dhe të përshtatura të marketingut ndërkombëtar nga ana e markave kosovare çka ndikon në njohjen e kufizuar të produkteve “Made in Kosovo” jashtë vendit. Studimi fokusohet në analizën e dy rasteve konkrete Devolli Group dhe Jafa Champion për të kuptuar mënyrën se si këto kompani kanë ndërtuar strategjitë e tyre të ndërkombëtarizimit cilat janë sfidat që kanë hasur dhe cilat janë praktikatat që mund të shërbejnë si model për marka të tjera vendore.

2.1 Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij studimi është tetrajtojë mënyrën se si markat kosovare përshtaten me kërkesat e tregjeve ndërkombëtare përmes strategjive të marketingut duke u fokusuar në elementet që i ndihmojnë të jenë konkurruese jashtë vendit. Përmes analizës krahasuese të dy rasteve Devolli Group një kompani me bazë të fortë industriale dhe përvojë të gjatë në eksport dhe Jafa Champion një markë moderne e orientuar drejt inovacionit dhe marketingut digjital synohet të kuptohet se si qasjet e ndryshme strategjike ndikojnë në suksesin ndërkombëtar të markave kosovare.

2.2 Objektivat e studimit

1. Të analizojë strategjitë e marketingut të përdorura nga markat kosovare gjatë hyrjes në tregjet ndërkombëtare.
2. Të krahasojë qasjet e Devolli Group dhe Jafa Champion duke vlerësuar efektivitetin e strategjive të tyre të përshtatjes në kontekste të ndryshme tregtare.

2.3 Pyetjet hulumtuese

1. Si arrijnë markat kosovare si Devolli Group dhe Jafa Champion të përshtatin strategjitë e tyre të marketingut për tregjet ndërkombëtare?
2. Cilat janë faktorët që ndikojnë më së shumti në suksesin ose vështirësitë e markave kosovare gjatë procesit të ndërkombëtarizimit?

3. METODOLOGJIA

Ky studim është ndërtuar mbi një qasje analitike dhe krahasuese duke u mbështetur kryesisht në shqyrtimin e literaturës teorike dhe analizën e rasteve konkrete të markave kosovare që kanë arritur të depërtojnë në tregjet ndërkombëtare. Synoi të kuptoj mënyrën se si markat kosovare përshtaten me kontekste të ndryshme kulturore, ekonomike dhe tregtare dhe mbi strategjitë e tyre të marketingut që kanë ndikuar në suksesin apo sfidat e tyre.

3.1 Dizajni i studimit

Studimi është konceptuar si një shqyrtim teorik me analizë krahasuese, i fokusuar në interpretimin cilësor të të dhënave nga burime dytësore përfshirë:

- ❖ artikuj shkencorë,
- ❖ raporte ekonomike,
- ❖ publikime të institucioneve ndërkombëtare dhe
- ❖ materiale promovuese të vetë kompanive të përzgjedhura.

Qasja krahasuese është përdorur për të analizuar ngjashmëritë dhe dallimet në strategjitë e marketingut ndërmjet dy markave kryesore kosovare Devolli Group dhe Jafa Champion të cilat janë përzgjedhur për shkak të prezencës së tyre aktive në tregjet e jashtme dhe ndikimit të tyre në formimin e imazhit të produkteve kosovare.

Devolli Group përfaqëson një rast tipik të një kompanie të konsoliduar me kapital të madh e cila ka ndërtuar markën e saj përmes investimeve afatgjata, diversifikimit të produkteve dhe standardizimit të cilësisë. Përmes markave si “Vita”, “Tepelene”, “KAFJA Devolli” dhe produkteve të tjera të eksportuara në Evropë kompania ka ndërtuar një identitet të

qëndrueshëm që kombinon origjinën kosovare me standardet ndërkombëtare të prodhimit (Devolli Group, 2023). Jafa Champion përfaqëson një rast më dinamik të një biznesi të mesëm që ka arritur të depërtojë në tregjet ndërkombëtare falë marketingut digjital, adaptimit të shijes së produktit sipas preferencave lokale dhe ndërtimit të një imazhi modern e rinor.

Përmes strategjisë së saj të komunikimit në rrjete sociale dhe pjesëmarrjes në panairë ndërkombëtare, Jafa Champion ka arritur të forcojë perceptimin e produkteve kosovare si të cilësore dhe konkurruese

4. Shqyrtimi i literatures

4.1 Konceptet dhe definicionet e markës në kontekstin ndërkombëtar

Koncepti i markës nuk mund të shihet më thjesht si një emër apo një logo që identifikon një produkt. Marka është bërë një gjuhë komunikimi midis biznesit dhe konsumatorit një mënyrë për të treguar historinë, origjinën dhe qëllimin e një kompanie.

Në tregjet ndërkombëtare ku konsumatorët kanë prirje dhe përvoja të ndryshme kulturore marka merr rolin e një urë lidhëse që duhet të përshtatet me çdo realitet të ri pa humbur thelbin e saj.

Një markë e fortë ndërkombëtare është ajo që arrin të ndërtojë identitet, besim dhe ndjeshmëri tek konsumatorët, pavarësisht vendit apo kulturës ku ajo shfaqet (Keller, 2013). Markat që kanë arritur sukses global si Apple apo Nike nuk janë të njohura vetëm për produktet që shesin por për vlerat dhe emocionet që përcjellin. Ato kanë krijuar një gjuhë universale që kapërcen kufijtë gjeografikë dhe kulturorë duke treguar se forca e markës qëndron në përvojën që ajo krijon jo vetëm në produktin që ofron (Kapferer, 2012).

Për vendet e vogla si Kosova, zhvillimi i një marke që mund të konkurrojë në tregjet ndërkombëtare është një proces që kërkon qartësi strategjike dhe ndërtim të kujdesshëm të identitetit. Kjo nënkupton se markat kosovare duhet të kuptojnë jo vetëm vlerat lokale që i bëjnë unike por edhe mënyrën si këto vlera mund të komunikohen dhe përshtaten për konsumatorët ndërkombëtarë. Një markë që synon tregjet e huaja duhet të dijë të ndërtojë narrativë të tregojë një histori që flet me emocione por që mbështetet në autenticitet dhe

cilësi. Marka nuk është më vetëm një mjet tregtar por bëhet përfaqësuese e kulturës dhe kreativitetit të një vendi të tërë (Anholt, 2007). Kjo është arsyeja pse shumë vende e shohin zhvillimin e markave kombëtare si pjesë të diplomacisë ekonomike sepse çdo produkt që hyn në tregjet e huaja mbart me vete një pjesë të imazhit të kombit që e prodhon. Në kuptimin teorik marka shihet si një kombinim i elementeve funksionale dhe emocionale.

Elementet funksionale lidhen me cilësinë, performancën dhe avantazhet e produktit ndërsa ato emocionale lidhen me mënyrën si konsumatori e ndien dhe e përjeton markën. Kjo ndarje është jetike për të kuptuar pse disa marka arrijnë të kenë ndikim të gjerë ndërkombëtar. Një markë që di të krijojë lidhje emocionale përmes komunikimit të sqartë dhe identitetit të qëndrueshëm mund të fitojë besnikëri shumë më të fortë sesa një markë që fokusohet vetëm në funksionalitet (De Mooij, 2019).

Kjo ndodh sepse konsumatorët në kultura të ndryshme reagojnë ndryshe ndaj vlerave, simboleve dhe mesazheve që markat përcjellin prandaj përshtatja e komunikimit është thelbësore për sukses ndërkombëtar. Në rastin e markave kosovare koncepti i markës duhet të ndërtohet mbi bazën e origjinalitetit, kreativitetit dhe rrëfimit të një historie autentike që lidhet me vlerat kulturore dhe shpirtin sipërmarrës të vendit. Në tregjet ndërkombëtare autenticiteti është një nga elementet më të kërkuara nga konsumatorët sepse ai i jep produktit një identitet të vërtetë dhe të veçantë.

Kjo do të thotë se një markë kosovare që dëshiron të hyjë në tregjet e huaja nuk duhet të kopjojë modelet perëndimore por të ndërtojë një imazh që tregon pse ajo është ndryshe dhe pse meriton vëmendje. Vetëm përmes kësaj qasjeje markat e vogla mund të pozicionohen me sukses në skenën globale dhe të ndërtojnë vlera të qëndrueshme në afatgjatë (Kotler & Keller, 2016).

4.2 Teoritë dhe modelet e ndërkombëtarizimit të markave

Procesi i ndërkombëtarizimit të markave kërkon një kuptim të thellë të mënyrës se si market:

- ❖ përshtaten,
- ❖ zhvillohen dhe
- ❖ konkurrojnë në tregje të ndryshme kulturore dhe ekonomike.

Ndërkombëtarizimi i markës nënkupton zgjerimin e qëllimshëm të një kompanie përtej kufijve kombëtarë për të ndërtuar një identitet global duke ruajtur njëkohësisht autenticitetin dhe vlerat e saj bazë. Ky proces është shumë më tepër sesa një strategji shitjesh është një formë komunikimi kulturor që kërkon ndjeshmëri, analizë dhe përshtatje ndaj realiteteve lokale (Cavusgil, Knight, & Riesenberger, 2017).

Një nga modelet më të njohura që shpjegon procesin e ndërkombëtarizimit të markave është modeli i Uppsala-s i cili e sheh zgjerimin ndërkombëtar si një proces gradual dhe të vazhdueshëm. Sipas këtij modeli kompanitë fillimisht hyjnë në tregje të huaja që janë më afër gjeografikisht dhe kulturorisht për të reduktuar pasigurinë dhe rrezikun.

Vetëm pasi fitojnë përvojë dhe njohuri nga këto tregje ato nisin të zgjerojnë veprimtarinë në tregje më të largëta dhe më të ndërlikuara (Johanson & Vahlne, 2009). Ky model është veçanërisht i rëndësishëm për vendet në zhvillim si Kosova ku kompanitë zakonisht kanë mungesë përvoja në tregjet ndërkombëtare dhe përballen me sfida të mëdha logjistike, financiare dhe institucionale.

Përmes një qasjeje graduale markat kosovare mund të mësojnë të përshtaten, të kuptojnë kulturat e reja të konsumit dhe të ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme me partnerë ndërkombëtarë. Në dekadat e fundit është vërejtur një ndryshim në mënyrën se si kompanitë ndërkombëtarizohen. Shumë marka të reja, veçanërisht ato të lidhura me teknologjinë dhe inovacionin, ndjekin modelin e ashtuquajtur “Born Global” që nënkupton se ato synojnë tregjet ndërkombëtare që në fazat e para të zhvillimit të tyre (Knight & Cavusgil, 2004).

Ky model thekson rolin e teknologjisë, digjitalizimit dhe globalizimit në lehtësimin e hyrjes së markave të reja në tregjet ndërkombëtare pa kaluar nëpër fazat tradicionale të zgjerimit. Një markë e modës apo e ushqimit artizanal nga Kosova mund të prezantojë produktet e saj në platforma si Amazon apo Etsy dhe të fitojë konsumatorë në Evropë apo SHBA brenda disa muajsh diçka që në të kaluarën do të kërkonte vite përgatitjeje dhe investime të mëdha.

Kjo tregon se dinamika e ndërkombëtarizimit po ndryshon në mënyrë të ndjeshme dhe markat që dinë të përdorin kanalet digjitale mund të kapërcejnë barrierat tradicionale të tregut (Cavusgil, 2017). Një tjetër teori e rëndësishme është ajo e avantazhit konkurrues të kombit e zhvilluar nga Michael Porter.

Ai argumenton se suksesin e një marke në tregjet ndërkombëtare e përcaktojnë katër faktorë kryesorë:

- ❖ kushtet e kërkesës në tregun vendas,
- ❖ kushtet e burimeve (si teknologjia, fuqia punëtore, infrastruktura),
- ❖ industritë mbështetëse dhe
- ❖ strategjitë e kompanive që operojnë brenda vendit (Porter, 1990).

Në rastin e Kosovës kjo teori nënvizon rëndësinë e zhvillimit të një ekosistemi të fortë ekonomik dhe institucional që ndihmon markat të rriten dhe të përballojnë konkurrencën ndërkombëtare. Një markë kosovare që synon tregjet e huaja ka nevojë për mbështetje nga institucionet shtetërore, politika eksporti të qarta, trajnime profesionale dhe akses në teknologji moderne që mundëson rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe menaxheriale.

Në literaturën bashkëkohore ndërkombëtarizimi i markës trajtohet gjithashtu si një proces i menaxhimit të marrëdhënieve kulturore. Globalizimi nuk nënkupton uniformitet por aftësi për të kuptuar dallimet kulturore dhe për t'u përshtatur ndaj tyre. Kjo është arsyeja pse shumë kompani ndjekin strategjinë e "glokalizimit" që do të thotë të mendosh globalisht por të vepresh lokalisht.

Një markë ndërkombëtare si McDonald's ka ruajtur imazhin e saj global por e përshtat menunë sipas preferencave lokale në çdo vend ku operon. Ky parim mund të zbatohet edhe nga markat kosovare që duan të hyjnë në tregjet ndërkombëtare duke ruajtur identitetin kombëtar por njëkohësisht duke i dhënë rëndësi adaptimit të produktit, dizajnit apo komunikimit sipas kulturës së tregut ku synojnë të hyjnë (De Mooij, 2019).

Modelet moderne të ndërkombëtarizimit theksojnë gjithnjë e më shumë rëndësinë e kapitalit social dhe njohurive ndërkombëtare. Ndërtimi i marrëdhënieve me partnerë të huaj, agjentë shpërndarës dhe rrjete biznesi bëhet faktor kyç për suksesin në tregjet globale (Johanson & Vahlne, 2009). Në rastin e markave kosovare të cilat shpesh përballen me kufizime financiare, këto lidhje mund të jenë burim i vlefshëm informacioni dhe mbështetjeje për të hyrë me sukses në tregje të reja.

Teoritë e ndërkombëtarizimit ofrojnë kuadër të rëndësishëm për të kuptuar se procesi i daljes së një marke përtej kufijve kombëtarë nuk është i njëtrajtshëm por ndikohet nga shumë faktorë përvoja e kompanisë, niveli i zhvillimit ekonomik të vendit, teknologjia, kultura, dhe aftësia për të ndërtuar marrëdhënie globale. Për Kosovën ku tregu i brendshëm

është i vogël dhe ndërkombëtarizimi është shpesh domosdoshmëri për rritje, kuptimi dhe aplikimi i këtyre modeleve është thelbësor për ndërtimin e strategjive të qëndrueshme të markimit ndërkombëtar. Vetëm në këtë mënyrë markat kosovare mund të krijojnë identitet të qëndrueshëm dhe të konkurrojnë me dinjtet në skenën globale.

4.3 Rëndësia e përshtatjes së markës për tregjet ndërkombëtare

Përshtatja nënkupton aftësinë e një marke për të transformuar mënyrën e komunikimit, dizajnin, mesazhin dhe vlerat e saj në mënyrë që të jenë të kuptueshme dhe të pranueshme për konsumatorët e kulturave të ndryshme. Kjo nuk nënkupton braktisjen e identitetit origjinal të markës por një proces të kujdesshëm të harmonizimit mes autenticitetit dhe fleksibilitetit strategjik.

Një markë që synon tregje të huaja duhet të ketë aftësinë të kuptojë kodet kulturore të konsumatorëve lokalë, të njohë tendencat e konsumit dhe të përshtatë mesazhet e saj për të ruajtur koherencën e identitetit duke shmangur njëkohësisht keqinterpretimet kulturore (De Mooij, 2019).

Në rastin e markave kosovare kjo përshtatje merr rëndësi të veçantë sepse shumë kompani vendore vijnë nga një mjedis ekonomik dhe kulturor i ri në proces zhvillimi dhe kërkojnë të depërtojnë në tregje më të mëdha si ai europian.

Për të qenë të suksesshme markat duhet të analizojnë me kujdes strukturën e tregut, preferencat e konsumatorëve dhe të ndërtojnë identitete që reflektojnë profesionalizëm, cilësi dhe vlera universale pa humbur lidhjen me origjinën lokale që shpesh është një element diferencues dhe emocionalisht i vlefshëm. Kjo strategji është vërtetuar efektive në disa marka nga rajoni, të cilat kanë arritur të krijojnë një “balancë kulturore” midis autenticitetit vendas dhe standardeve ndërkombëtare të komunikimit të marketingut (Dragoti, 2014).

Rëndësia e përshtatjes së markës shpjegohet përmes koncepteve të “standardizimit” dhe “adaptimit”. Strategjitë e standardizimit theksojnë ruajtjen e një identiteti të përbashkët global ndërsa strategjitë e adaptimit theksojnë ndryshimin sipas kërkesave të tregut lokal. Suksesi qëndron në aftësinë për të kombinuar të dy qasjet në mënyrë që markat të jenë të qëndrueshme në imazh por fleksibile në përmbajtje. Në këtë aspekt markat kosovare duhet

të zhvillojnë një qasje të “adaptimit selektiv” ku ruhet thelbi identitar por përmbajtja komunikative ndryshohet sipas audiencës ndërkombëtare duke respektuar diferencat gjuhësore, sociale dhe simbolike të tregjeve ku operojnë (Kotler & Keller, 2016). Edhe autorët shqiptarë kanë theksuar se ndërkombëtarizimi i markave nga hapësira shqiptare nuk mund të ndodhë pa një proces të mirëfilltë të përshtatjes kulturore dhe menaxhimit strategjik të imazhit.

Markat shqiptare dhe kosovare duhet të shohin tregun global jo vetëm si një mundësi shitjeje por si një arenë komunikimi kulturor ku përfaqësohet identiteti ekonomik dhe kombëtar. Kjo nënkupton që përshtatja nuk është vetëm një kërkesë tregtare por edhe një proces i krijimit të urave të besimit dhe respektit midis kulturave të ndryshme. Një markë që respekton kulturën e tjetrit dhe e reflekton këtë respekt në komunikim fiton jo vetëm konsumatorë por edhe një reputacion afatgjatë ndërkombëtar (Pajaziti, 2020).

4.4 Strategjitë e pozicionimit të markës në tregjet ndërkombëtare

Pozicionimi i markës është një nga elementët më kritikë në procesin e ndërkombëtarizimit sepse përcakton mënyrën se si konsumatori ndërkombëtar e percepton markën në krahasim me konkurrentët e saj. Pozicionimi është premtimi unik që një markë i bën tregut përmes një kombinimi të qartë të vlerave, cilësisë dhe identitetit që ajo përfaqëson (Aaker, 2010).

Në një treg global ku konsumatori është i ekspozuar ndaj një morie alternativash, sukcesi i markës varet nga aftësia e saj për të krijuar një diferencim të qëndrueshëm një arsye të fortë pse konsumatori duhet të zgjedhë pikërisht atë markë. Kjo qasje kërkon jo vetëm kreativitet në komunikim por edhe një analizë të thelluar të perceptimeve, nevojave dhe vlerave të konsumatorëve në secilin treg ku synohet hyrja (Kotler & Keller, 2016).

Strategjia e pozicionimit ndërkombëtar është ende një proces në zhvillim. Shumë kompani vendore janë në fazën e ndërtimit të identitetit të tyre global dhe shpesh përballen me sfida si mungesa e njohjes ndërkombëtare, konkurrenca e fortë nga markat e konsoliduara dhe paragjykimet që mund të ekzistojnë për origjinën e produkteve nga tregjet e vogla ose në zhvillim.

Markat kosovare duhet të ndjekin një strategji pozicionimi që mbështetet në avantazhet krahasuese që ato ofrojnë qoftë:

1. cilësia artizanale,
2. autenticiteti kulturor,
3. kreativiteti lokal apo
4. fleksibiliteti në shërbim.

Një shembull i qartë janë markat kosovare në industrinë e verërave, produkteve ushqimore organike apo artizanatit të cilat kanë arritur të krijojnë një imazh unik duke kombinuar traditën dhe inovacionin si elementë që komunikojnë autenticitet dhe besueshmëri (Gjonbalaj, 2019).

Pozicionimi i markës ndërtohet mbi tre shtylla themelore:

- ❖ identitetin,
- ❖ imazhin dhe
- ❖ besnikërinë.

Identiteti përfaqëson mënyrën se si marka dëshiron të perceptohet, imazhi është perceptimi real i konsumatorëve ndërsa besnikëria është rezultati i përputhjes së premtimeve me përvojën reale të konsumatorit.

Për markat që hyjnë në tregjet ndërkombëtare, sfida kryesore është ruajtja e koherencës mes këtyre tre shtyllave në kultura të ndryshme. Një markë që pozicionohet si premium në tregun vendor duhet të sigurohet që ky perceptim të përkthehet në mënyrë të qëndrueshme edhe në tregjet ndërkombëtare përmes dizajnit, paketimit, çmimit dhe komunikimit vizual (Aaker, 1996).

Autorët shqiptarë kanë theksuar rëndësinë e përqendrimit në vlerat emocionale të markës gjatë procesit të pozicionimit. Një markë që ndërton marrëdhënie emocionale me konsumatorët përmes tregimeve të sinqerta, origjinalitetit kulturor dhe qëndrimeve etike krijojnë një kapital të fortë simbolik që e ndihmon të qëndrojë konkurruese edhe përballë markave globale. Markat kosovare duhet të shfrytëzojnë trashëgiminë kulturore, dizajnin e veçantë dhe historinë lokale për të ndërtuar një narrativë të besueshme që lidhet me rrënjët por njëkohësisht flet në një gjuhë universale që kuptohet nga konsumatori global. Kjo

strategji e autenticitetit të lokalizuar është një nga mënyrat më efektive për të fituar besim dhe diferencim në tregjet ndërkombëtare (Dibra, 2018).

Një tjetër element që përcakton suksesin e pozicionimit është koherenca ndërmjet komunikimit të markës dhe përvojës reale që ajo ofron. Nëse mesazhi që dërgon marka nuk përputhet me realitetin e produktit apo shërbimit perceptimi i saj bie menjëherë. Për të krijuar një pozicionim të qëndrueshëm në tregjet ndërkombëtare, kompanitë duhet të ndërtojnë një hierarki vlerash ku çdo aspekt i markës nga cilësia e produktit te mënyra e shpërndarjes forcon imazhin që dëshirohet të projektohet.

Për markat kosovare kjo do të thotë që çdo detaj nga ambalazhi deri te mënyra e prezantimit në panairë ndërkombëtare duhet të reflektojë profesionalizëm dhe standard global duke e vendosur markën si një konkurrent serioz në sytë e konsumatorëve ndërkombëtarë (Keller, 2013). Pozicionimi ndërkombëtar i markës nuk është vetëm një proces marketingu por një strategji e plotë që lidh produktin me kulturën, përvojën me perceptimin dhe identitetin me qëllimin. Ky është një hap i domosdoshëm drejt ndërtimit të një reputacioni të qëndrueshëm që tejkalon kufijtë gjeografikë dhe kulturore duke i dhënë Kosovës një zë të dallueshëm në tregun global (Pajaziti, 2020).

4.5 Strategjitë e komunikimit ndërkulturor në marketingun ndërkombëtar

Strategjitë e komunikimit ndërkulturor përfaqësojnë mënyrën se si një markë përshtat mesazhet, simbolet, tonin dhe kanalet e saj të komunikimit për t'u kuptuar saktë nga audienca ndërkombëtare pa humbur autenticitetin dhe identitetin origjinal. Një komunikim i suksesshëm ndërkulturor kërkon jo vetëm përkthimin e gjuhës por interpretimin e kulturës ku çdo ngjyrë, figurë apo slogan mund të ketë kuptime të ndryshme në kontekste të ndryshme shoqërore (De Mooij, 2019).

Një fushatë marketingu që funksionon në Evropën Perëndimore mund të dështojë në Azi nëse nuk merr parasysh simbolikën kulturore të ngjyrave, zakonet e komunikimit apo raportin e konsumatorit me autoritetin dhe traditën. Kjo tregon se komunikimi ndërkulturor është më shumë një proces sociologjik dhe psikologjik sesa vetëm estetik. Markat që arrijnë të zhvillojnë ndjeshmëri kulturore (cultural sensitivity) fitojnë një avantazh konkurrues

sepse ndërtojnë besim dhe lidhje emocionale me konsumatorët e huaj që janë shumë më të vështira për t'u arritur përmes mesazheve standarde dhe të ftohta (Hall, 1976). Kjo çështje merr një dimension të veçantë. Markat kosovare që synojnë tregjet ndërkombëtare duhet të kuptojnë se mënyra e komunikimit të tyre shpesh është përfaqësuese e një kulture të re ekonomike që po kërkon vendin e vet në botë. Komunikimi duhet të jetë i kujdesshëm, përfaqësues dhe i bazuar në vlera që janë universalisht të pranueshme si profesionalizmi, sinqeriteti dhe cilësia.

Kompanitë kosovare shpesh kanë një avantazh unik sepse përfaqësojnë energjinë e një tregu të ri, kreativ dhe fleksibil por mungesa e përvojës ndërkombëtare në komunikim mund të shkaktojë keqkuptime dhe humbje të mesazhit origjinal. Trajnimi në komunikim ndërkulturor dhe përdorimi i ekspertëve të marketingut global është një domosdoshmëri për markat që duan të ndërtojnë imazh afatgjatë jashtë vendit (Pajaziti, 2021).

Një strategji e rëndësishme në këtë kontekst është glocalizimi (glocalization) një term që kombinon globalen me lokalen. Ai nënkupton përshtatjen e përmbajtjes globale të markës me karakteristikat lokale të tregut ku ajo operon. Në praktikë kjo do të thotë që marka ruan vizionin dhe imazhin global por përshtat mesazhet, produktet dhe përvojën sipas kulturës vendore (Robertson, 1995). Një markë kosovare që eksporton produkte ushqimore në Gjermani mund të ruajë identitetin autentik të origjinës por në të njëjtën kohë të modifikojë mënyrën e paketimit dhe komunikimit për t'u përshtatur me stilin minimalist dhe ekologjik që preferojnë konsumatorët gjermanë.

Kjo strategji lejon ndërtimin e një identiteti që është njëkohësisht lokal dhe global duke e bërë markën të afërt dhe të besueshme për tregun e huaj. Komunikimi ndërkulturor është thelbësor në ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata me konsumatorët dhe partnerët ndërkombëtarë. Suksesi në marketing ndërkombëtar nuk përcaktohet vetëm nga cilësia e produktit apo çmimi por nga aftësia për të komunikuar në mënyrë që të kuptohet dhe të respektohet nga kultura tjetër.

Markat kosovare duhet të zhvillojnë aftësi të larta të komunikimit interkulturor përmes përdorimit të rrjeteve sociale, platformave digjitale dhe mesazheve që shprehin transparencë dhe respekt. Një komunikim që ndërton marrëdhënie jo vetëm që rrit njohjen e markës por krijon edhe kapital reputacional që ndikon në vendimmarrjen e

konsumatorëve (Samovar & Porter, 2014). Komunikimi ndërkulturor nuk është thjesht një pjesë e strategjisë së marketingut por është themeli mbi të cilin ndërtohet marrëdhënia midis markës dhe konsumatorit global. Për markat kosovare, sfida qëndron në krijimin e një zëri të unifikuar që flet në mënyrë të kuptueshme për kultura të ndryshme pa humbur autenticitetin kombëtar që i bën të veçanta. Ato jo vetëm që përfaqësojnë veten por edhe identitetin e Kosovës në arenën globale si një vend i inovacionit, kreativitetit dhe energjisë së re ekonomike (Pajaziti, 2021).

4.6 Ndikimi i kulturës në perceptimin dhe pozicionimin e markës në tregjet ndërkombëtare

Kultura përfshin një sistem të ndërlikuar vlerash, normash, besimesh dhe simboleve që ndikojnë drejtpërdrejt në sjelljen e blerjes dhe në mënyrën se si njerëzit ndërtojnë marrëdhënie me market ku çdo kulturë ka dimensione të veçanta si individualizmi kundrejt kolektivizmit, distanca ndaj pushtetit apo shmangia e pasigurisë të cilat ndikojnë në mënyrën se si konsumatorët perceptojnë mesazhet e marketingut dhe çfarë presin nga një markë.

Një strategji e suksesshme ndërkombëtare e pozicionimit duhet të marrë në konsideratë jo vetëm analizën e tregut por edhe kontekstin kulturor ku marka dëshiron të depërtojë (Hofstede, 2011).

Kultura ndikon në tre nivele kryesore të marrëdhënies konsumator markë:

- ❖ njohjen,
- ❖ interpretimin dhe
- ❖ besnikërinë.

Njohja varet nga mënyra se si një markë prezantohet dhe si lidhet me simbolet lokale. Ngjyra e kuqe mund të nxisë emocione të ndryshme në kultura të ndryshme pasion dhe energji në Perëndim por fat dhe mirëqenie në kulturat aziatike. Në interpretim konsumatorët japin kuptime të ndryshme ndaj vlerave të markës, në varësi të kontekstit social dhe përvojës së tyre kolektive.

Në aspektin e besnikërisë lidhja afatgjatë ndërtohet mbi ndjesinë që marka reflekton dhe respekton identitetin kulturor të konsumatorit (De Mooij, 2019). Kultura vendore ofron një

identitet të fortë që mund të kthehet në avantazh strategjik për pozicionimin ndërkombëtar. Markat kosovare duke u mbështetur në vlera si mikpritja, solidariteti dhe kreativiteti mund të krijojnë një narrativë unike që i dallon në tregjet globale. Identiteti kulturor shqiptar dhe kosovar ka potencial të shërbejë si burim vlerash autentike për marketingun në epokën e konsumatorit që kërkon produkte me histori dhe ndjenja reale pas tyre.

Kjo nënkupton se kultura nuk duhet parë si pengesë për ndërkombëtarizimin por si një aset strategjik që i jep markës autenticitet dhe personalitet të dallueshëm (Bajrami, 2020). Pozicionimi kulturor i markës nënkupton ndërtimin e një imazhi që rezonon emocionalisht me publikun e synuar. Pozicionimin është vendi që marka zë në mendjen e konsumatorit në raport me konkurrencën. Në tregjet ndërkombëtare ky pozicionim është i lidhur ngushtë me perceptimin kulturor një markë që nuk përshtatet me mënyrën e të menduarit lokal rrallë arrin të krijojë besim afatgjatë.

Një kompani kosovare që shet produkte natyrale duhet të përfshijë në mesazhin e saj elemente që reflektojnë autenticitetin dhe respektin ndaj natyrës sepse këto janë vlera që kanë peshë të madhe në tregjet perëndimore. Rëndësia e integritetit të elementeve kulturore në komunikimin e markës duke përdorur simbole, ngjyra dhe narrativë që ruajnë identitetin kombëtar por që janë të kuptueshme dhe tërheqëse për konsumatorët e huaj.

Kjo qasje është e domosdoshme për markat kosovare që synojnë ndërtimin e një identiteti global sepse e vendos kulturën si pikë takimi mes origjinës lokale dhe audiencës ndërkombëtare. Kultura bëhet jo vetëm një mjet i komunikimit por edhe një burim besimi dhe diferencimi në treg (Krasniqi, 2021). Ndikimi i kulturës në perceptimin dhe pozicionimin e markës është një faktor kyç që përcakton suksesin ose dështimin në tregjet ndërkombëtare. Një markë që arrin të kuptojë dhe respektojë kulturën lokale duke ruajtur njëkohësisht autenticitetin e saj origjinal, krijon lidhje emocionale dhe vlera afatgjata me konsumatorët. Për markat kosovare, kjo përkthehet në ndërtimin e një strategjie që përziën krenarinë kombëtare me fleksibilitetin kulturor duke e bërë identitetin vendas një urë të komunikimit global.

4.7 Sfidat dhe mundësitë e markave kosovare në tregjet ndërkombëtare

Sfidat me të cilat përballen markat kosovare gjatë procesit të ndërkombëtarizimit janë të shumta dhe shumëdimensionale. Në radhë të parë pengesat burokratike dhe mungesa e njohjes ndërkombëtare të shtetit të Kosovës në disa vende krijojnë vështirësi serioze në aspektin ligjor dhe institucional për eksportuesit dhe për kompanitë që kërkojnë të krijojnë bashkëpunime ndërkufitare.

Kjo ndikon drejtpërdrejt në krijimin e marrëveshjeve tregtare dhe partneriteteve ndërkombëtare. Mungesa e infrastrukturës adekuate logjistike, standardeve të harmonizuara dhe njohjes së certifikatave të cilësisë për produktet kosovare shpesh e bën më të vështirë konkurrencën me markat e konsoliduara nga vendet e BE-së apo SHBA-së (Gjonbalaj & Fejza, 2021). Këto sfida krijojnë një ambient ku vetëm kompanitë me aftësi të forta menaxheriale me një qasje të qartë strategjike dhe me fleksibilitet në përshtatjen ndaj tregjeve të reja mund të mbijetojnë dhe të zhvillohen.

(Gjonbalaj & Fejza, 2021) Një sfidë tjetër e rëndësishme lidhet me perceptimin e markës kosovare në tregjet e huaja. Shumë konsumatorë ndërkombëtarë kanë njohuri të kufizuara ose stereotipe lidhur me produktet që vijnë nga Ballkani çka e bën të nevojshme ndërtimin e një identiteti të qëndrueshëm që përfaqëson cilësi, autenticitet dhe inovacion. Strategjitë e komunikimit luajnë një rol jetik në këtë proces pasi përmes tyre mund të ndryshohen perceptimet ekzistuese dhe të krijohet një imazh më pozitiv e konkurrues.

Krijimi i besimit ndërkombëtar është proces i gjatë që kërkon jo vetëm marketing të mirë por edhe angazhim të vazhdueshëm në transparencë, përgjegjësi sociale dhe cilësi të lartë. Markat kosovare të birrës, tekstilit apo produkteve ushqimore të cilat kanë filluar të eksportojnë në tregjet e rajonit dhe më gjerë kanë kuptuar se suksesi nuk qëndron vetëm në çmim por në vlerën simbolike që arrijnë të transmetojnë te konsumatori i huaj.

(Dibra, 2018) Nuk mund të anashkalohe fakti se sfidat janë të lidhura edhe me mungesën e eksperiencës ndërkombëtare të menaxherëve dhe profesionistëve të marketingut në Kosovë. Shumë kompani lokale nuk kanë departamente të mirëfillta të marketingut ndërkombëtar dhe shpesh mbështeten në praktika tradicionale që nuk janë të përshtatshme

për tregje dinamike dhe shumëkulturore. Kjo mospërgatitje ndikon në mungesën e strategjive të personalizuara për segmentet e ndryshme të konsumatorëve dhe në moskuptimin e sjelljes konsumatore në vende të tjera. Njohja e kontekstit kulturor dhe ekonomik të tregut është thelbësore për të shmangur dështimet strategjike dhe për të krijuar një ofertë që rezonon me nevojat dhe vlerat e konsumatorëve lokalë.

Nevojitet që kompanitë kosovare të investojnë më shumë në trajnime profesionale dhe në kërkime të tregut ndërkombëtar. (Leonidou, 2018) Krahas sfidave ekzistojnë edhe mundësi të mëdha që mund të shfrytëzohen nëse zhvillohet një qasje e integruar dhe inovative. Tregjet ndërkombëtare sot janë më të hapura ndaj markave të reja sidomos atyre që përfaqësojnë identitet kulturor unik dhe që ofrojnë produkte me vlera të qëndrueshme ekologjiksht. Kosova me trashëgiminë e saj kulturore, burimet natyrore dhe kreativitetin e rinisë ka potencial për të ndërtuar marka autentike që mund të konkurrojnë përmes dallueshmërisë.

Përparësia e markave të vogla që vijnë nga tregje në zhvillim qëndron në aftësinë e tyre për të qenë fleksibël dhe për t'u përshtatur shpejt me ndryshimet e tregut global. Shembuj të tillë mund të gjenden në industrinë e modës, artizanatit, produkteve bio dhe gastronomisë tradicionale, të cilat mund të shërbejnë si ura për hyrje në tregjet evropiane. (Gashi & Kastrati, 2020) Një aspekt tjetër thelbësor që duhet trajtuar është përdorimi i teknologjisë dhe platformave digjitale. Tashmë marketingu digjital ka eliminuar shumë barrierë fizike dhe financiare që dikur e bënin të vështirë hyrjen në tregje të huaja. Kompanitë kosovare që përdorin strategji të integruara digjitale si komunikimin përmes mediave sociale, marketingun përmbajtësor (content marketing) dhe platformat e shitjeve online kanë filluar të arrijnë njohje ndërkombëtare pa pasur nevojë për investime kolosale në infrastrukturë.

Digjitalizimi mund të përdoret për të ndërtuar një identitet më bashkëkohor dhe për të pozicionuar produktet kosovare si të denja për tregun global. Epoka digjitale ka transformuar mënyrën se si konsumatorët perceptojnë markat dhe si ato ndërtojnë marrëdhënie me publikun nga një komunikim njëdrejtimësh në një dialog interaktiv. Kjo paraqet një mundësi reale për markat e reja përfshirë ato kosovare për të krijuar lidhje emocionale dhe besnikëri në nivele ndërkombëtare. (Kotler, 2021) Mund të thuhet se sfidat e markave kosovare nuk duhet parë vetëm si pengesa por si mundësi për transformim dhe përshtatje. Nëse bizneset vendase arrijnë të ndërthurin inovacionin, autenticitetin kulturor

dhe strategjitë moderne të marketingut atëherë procesi i ndërkombëtarizimit nuk do të mbetet vetëm një ambicie por do të bëhet realitet i prekshëm. Ky tranzicion kërkon një bashkëpunim më të madh ndërmjet institucioneve shtetërore, sektorit privat dhe universiteteve në mënyrë që të krijohet një ekosistem i qëndrueshëm që mbështet konkurrencën ndërkombëtare të markave kosovare.

4.8 Ndikimi i kulturës dhe identitetit kombëtar në ndërtimin e markës ndërkombëtare

